# KONTRATE SHITBLERJE

Sot me daten 1 Shkurt 1997 para meje avokat Llambi Qirilla,i dhomes se avokateve Korce u paraqiten :

1- Anesti Foto,i biri i Kostas,datelindja 1963,me banim Rr"Rexhep Telhaj",P.16,Shk. A/8 Korce.

2- Sotir Lolo,i biri i Kocos,datelindja 1955,me banim Rr"Pano Xhaballo",P. 21,Shk. A/6 Korce.

qe paraqiten ne cilesine e shitesit dhe

1- Kostandin Gjata,i biri i Kristaqit,datelindja 1965,me banim Bulevard "Republika",P. 16,Shk. C/6 Korce,

qe paraqitet ne cilesine e bleresit,te cilet kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje per sende te luajtshme me permbajtjen e meposhtme:

Shitesit deklaruan se jane ortake ne Shoqeria "TOLO-TUR-KORCA" ShPK Korce,ne te cilen kane sejcili nga 33,333 leke,ose sejcili nga 33.333% te kapitalit themeltar,gje qe vertetohet me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane,me te cilin eshte regjistruar shoqeria ne Regjistrin Tregetar,si dhe aktin e themelimit dhe statutin qe i bashkangjiten ketij vendimi.Ata,me vullnetin e lire e te pa vesuar,deshirojne te shesin kapitalin e tyre themeltar ne kete shoqeri me cmimin qe perfaqeson vete vlera e kapitalit e shprehur ne leke prej 33333 leke sejcili,duke dhene pelqimin qe bleres i ketij kapitali te jete ortaku i trete i kesaj shoqerie Kostandin Gjata.

Nga ana e tij bleresi Kostandin Gjata,deklaron me vullnetin e lire e te pa vesuar,se eshte dakort te blere kapitalin e dy ortakeve te tjere te shoqerise se tyre,qe perbehet 33,333 leke per Sotir Lolon dhe 33,333 leke per Anesti Foton,gjithsej 66,700 leke,dhe eshte dakort me cmimin e shitjes se ketij kapitali,qe perfaqeson vete vleren e tij te shprehur ne leke.Ne kete menyre bleresi Kostandin Gjata behet zoterues i te gjithe kapitalit themeltar te shoqerise "TOLO-TUR-KORCA" ShPK Korce ne masen 100%.

Te dyja palet deklaruan para meje se shuma e lekeve per blerjen e kapitalit eshte paguar prej bleresit tek te dy shitesit,sipas vleftes se kapitalit qe zoteron sejcili prej shitesave.

Kontrata perpilohet ne tre kopje,te cilat do te noterizohen, dhe do te behet regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Kontrata u lexua prej sejciles pale,te cilet jane dakort me permbajtjen e saj dhe mbasi nuk kane verejtje,nenshkruajne ate.

P A L E T

Shitesit

1- Anesti Foto

2- Sotir Lolo

Bleresi

Kostandin Gjata